

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E PROJEKTIT TE KERKIM ZBULIMIT,
ZONA MINERARE NR.566/1,
OBJEKTI "SUROJ", NJESIA ADMINISTRATIVE SURROJ, QARKU
KUKES.**



SHOQERIA: "PEPA GROUP" SH.P.K,

PËRGATITËN RAPORTIN

STUDIO "OSKEOLA" SH.P.K



Inxh.Hekuran MUÇA. Nr. Lic. 258



Studio projektuese " Oskeola" sh.p.k
Nr.cel 068 50 95 197
Email : indrit.hilaj@yahoo.com

Te dhëna te përgjithshme mbi objektin e kerkim zbulimit "Surroj", Surroj, Qarku Kukes.

I.- 1 Shoqëria kërkon te pajiset me leje minerare kërkim zbulimi.

Shoqëria "Pepa Group" Sh.p.k, kërkon te pajiset me leje kërkim zbulim, për mineral kromi, ne zonën minerare nr.566/1, objekti "Surroj", bashkia Kukes, qarku Kukes.

I.-2 Vendndodhja e objektit

Nga shoqëria **PEPA GROUP " sh.p.k** në zbatim të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve ligjore në zbatim të tij, është pajisur me leje minerare kërkim-zbulimi sipas ligjit të ri minerar. Sipërfaqja e zonës është në përputhje me atë që lejon Ligji aktual minerar prej **7.014 km²**, i fituar me tender për zonat konkurruese. Sipërfaqja në të cilën kërkohet leje minerare për kerkim mineral kromi bën pjesë në planshetat topografike në shk 1:25000 me nomenklature: plansheti K-34-65-D-c (Kalimash) dhe planshetin K-34-77-B-a (Surroj) që kufizohet nga këto koordinata kilometrike:

Tabelen nr.1

Kordinata e zonës nr.566/1

Pikat	X	Y
1	4652166	4440984
2	4654355	4441863
3	4654084	4442885
4	4651555	4443178
5	4650750	4443134
6	4650647	4442585
7	4650635	4441964
8	4650151	4441858
9	4650161	4440964

Sipërfaqja S=.7.014 km²

I.-3 Topografia dhe klima e zonës

Zona minerare me numër identifikues *Nr. 566/1*, ku përfshihen *vendburimi Kodër Luç – 1, Kodra e Shqipes, shfaqjet e mineralizuar nr.2 (Livadhi i Laskut), nr. 6 (Stani i Jakupit), nr.10 (Stani Can Lushës), nr .19 dhe 20 sipas Hartës Gjeologjike strukturale e masivit ultrabazik të Kukësit me autor Isa Baja Haki Caçlli viti 1968* për të cilën kërkohet leja minerare e kërkim-zbulimit e cila përfshihet në planin vjetor minerar të miratuar për vitin 2018 që në ndodhen në pjesen jug-perendimore të masivit ultrabazik të Kukësit.e vizatuar në hartën e shkallës 1:25000 dhe vendoset në plansheti K-34-65-D-c (Kalimash) dhe planshetin K-34-77-B-a (Surroj) Kufizohet nga këto koordinata të cilat jepen në tabelën nr.1 dhe nr.1/1 . të përshkruar me sipër

Qendra e njësisë administrative e Surrojit dhe lidhet me qytetin e Kukesit me rruge automobilistike te K1.III-të e gjatë 25 km. Në stinën e dimrit shpesh rruga bllokohet nga dëborë

Klima

Territori i kërkuar për leje kërkimi karakterizohet nga klimë kontinentale, me vere të freskët dhe dimër të ftohtë Temperatura mesatare vjetore në Kukës vlerësohet 11.8⁰ celsius. Temperatura mesatare e janarit në Kukës vlerësohet 0.5⁰, ndërsa ajo e korrikut 22⁰. Vlerat me të larta dhe më të ulta të matura në Kukës janë 39.5⁰ dhe – 21⁰. Reshjet vjetore luhaten në mes 800-1200 mm në vit. Sasia mesatare vjetore e reshjeve në Kukës është 893 mm. Shpërndarja vjetore e reshjeve ka karakter mesdhetar. Stina e verës është e thatë dhe përfaqëson jo më shumë se 10% të sasisë mesatare vjetore të reshjeve. Një pjesë e reshjeve nga muaji dhjetor në Mars bien në formë dëbore. Janë të zakonshme reshjet 0.2 deri 0.5 metër. Trashësia me e madhe e matur në Bicaj është 1.54 metër. Ndërsa në territorin në studim me rritjen e lartësisë mbi nivelin e detit rritet edhe lartësia maksimale e dëborës, për të kaluar 2 m.

Bimësia e zonës

Zona që kërkohet leje minerare , është kryesisht zone me bimësi jo shumë të zhvilluar. Përfaqësohet kryesisht nga shkurre bushi, dëllinjë dhe me pak lis apo frashër. Në lartësitë mbi 800 metër gjen zhvillim me të madh lisi. Në kurrizoren ndarëse të këtij sektori gjejmë zhvillim rrafshina të kufizuara pa bimësi të lartë. Mbi lartësinë 850 m të objektit, takohen pyje me dru ahu. dhe pishe .Vete sipërfaqja ku do të kërkohet leja e kërkim - zbulimit është pothuajse e zhveshurose me shkurre të rralla, si dhe nuk ka tokë bujqësore mbi atë. Theksojme gjithashtu se në këtë sipërfaqe nuk ka vepra arti, argjinatura dhe vepra hidroenergjitike

Hidrografia dhe Hidrogjeologjia

Zona përshkohet nga Zona e Surrojit ndërpritet prej përrenjve të shumtë, të cilët mblidhen në përrojin e Leshmces, debiti i tyre ulet shumë në stinën e verës dhe një pjesë thahen. Kuota me e ulet është gjatë luginës së Leshnicës 400-600 m .Zona përshkohet edhe nga disa proska, të cilat kanë ujë vetem gjatë periudhës së reshjeve. Në brendësi të zonës ku do kryeh punimet e zbulimit,

nuk ka burime ujrash. Lidhur me veprimtarinë e ujrave nëntoksorë, kushtet hidrogjeologjike të zonës minerare 566/1 ku do të kryhen punime kërkim-zbulimi, janë shumë të përshtatëshme dhe nuk përbëjnë ndonjë problem për shfrytëzimin e këtij objekti në të ardhmen

Si përfundim zona minerare 566/1, ka kushte të thjeshta hidrogjeologjike, ujrave nëntokësore lidhen me çarjet e shkëmbinjve dunite-harcburgitik që ndërtojnë zonën ku ato lokalizohen dhe drenojnë mjaft mire nëpërmjet rrjetit të dendur dhe të thellë të përrenjve që i përshkojnë ato.

Demografia, infrastruktura ekzistuese etj.

Qendra administrative e rajonit është bashkia i Kukësit. Sektori ku programohet të realizohet zbulimi për mineralin e kromit zhvillohet në teritore kodrinore-malore dhe pothuaj jashtë qendrave të banuara. Fshatrat me të afërta në pjesën veriore të territorit në studim janë Mamzi dhe Fushë Dukagjini ne Veri dhe Qinamak, Surroj , Aliaj në Jug.i gjithë territori në studim përshkohet nga rruga automobilistike e cila lidh qytetin e Kukësit me Surrojin dhe Qafë Komin. Në pjesën lindore të territorit filluar nga Fushë Dukagjini zhvillohet autostrada Durrës Kukës (segmenti F.Dukagjin - Hyrje e tunelit Kalimash). Kjo mes atributesh të saj, krijon kushte të favorëshme edhe në fushën e shfrytëzimit të mineraleveë dobishme.Krahina furnizohet me energji elektrike nëpërmjet linjës 10 k/Volt .

Infrastruktura ekzistuese.

Qendra administrative e rajonit është bashkia i Kukësit. Sektori ku programohet të realizohet zbulimi për mineralin e kromit zhvillohet në teritore kodrinore-malore dhe pothuaj jashtë qendrave të banuara. Fshatrat me të afërta në pjesën veriore të territorit në studim janë Mamzi dhe Fushë Dukagjini ne Veri dhe Qinamak, Surroj , Aliaj në Jug.i gjithë territori në studim përshkohet nga rruga automobilistike e cila lidh qytetin e Kukësit me Surrojin dhe Qafë Komin. Në pjesën lindore të territorit filluar nga Fushë Dukagjini zhvillohet autostrada Durrës Kukës (segmenti F.Dukagjin - Hyrje e tunelit Kalimash). Kjo mes atributesh të saj, krijon kushte të favorëshme edhe në fushën e shfrytëzimit të mineraleveë dobishme.Krahina furnizohet me energji elektrike nëpërmjet linjës 10 k/Volt .

I gjithë territori në studim përshkohet nga rruga automobilistike e cila lidh qytetin e Kukësit me Surrojin dhe Qafë Komin. Në pjesën lindore të territorit filluar nga Fushë Dukagjini zhvillohet autostrada Durrës Kukës (segmenti F.Dukagjin - Hyrje e tunelit Kalimash). Kjo autostrade mes atributesh të rëndësishme të saj, krijon kushte të favorëshme edhe në fushën e shfrytëzimit të mineraleve të dobishme. Krahina furnizohet me energji elektrike nëpërmjet

I.7 Te dhena te shkurtra per vendburimin.

Objekti ne fjale qe zotëron leje minerare administrativisht ka gene ne juridiksionin e minierës se kromit te Kalimashit, rrethit Kukes.Punimet ne kete objekt do te fillojnë me marrjen e lejes se kërkim zbulimit.

Pershkrimi i qellimit te projektit te propozuar

Ne ketë raport teknik përfshihet objekt "Surroj" sipas njoftimit te fituesit nr 15255/2 date 10/01/2019 te Ministrisë se Infrastruktures dhe Energjisë, ne te cilën jepet sipërfaqja e zonës 7.014km².Ky studim është hartuar me kerkesete administratorit te subjektit "Pepa Group" Sh.p.k. "Person Juridik" me perfaqesues ligjor Z. Urim Pepa Zona minerare me numër identifikues Nr. 566/1, ku përfshihen vendburimi Kodër Luç – 1, Kodra e Shqipes, shfaqjet e mineralizuar nr.2 (Livadhi i Laskut), nr. 6 (Stani i Jakupit), nr.10 (Stani Can Lushës), nr .19 dhe 20 sipas Hartës Gjeologjike strukturale e masivit ultrabazik të Kukësit, për të cilën kërkohet leja minerare e kërkim-zbulimit e cila përfshihet në planin vjetor minerar të miratuar për vitin 2018 që në ndodhen në pjesen jug-perendimore të masivit ultrabazik të Kukësit.e vizatuar në hartën e shkallës 1:25000 dhe vendoset në plansheti K-34-65-D-c (Kalimash) dhe planshetin K-34-77-B-a (Surroj) Kufizohet nga këto koordinata të cilat jepen në tabelën nr.1 dhe nr.1/1 . të përshkruar me sipër

Qendra e njësisë administrative e Surrojit dhe lidhet me qytetin e Kukesit me rruge automobilistike te K1.III-të e gjatë 25 km.. Kerkim zbulimi i metejshem eshte nderprere per mungese te dhenash. Zona ndodhet mes kuotave +1100 deri + 1650 m mbi nivelin e detit.

Siperfaqja e zones se kerkuar per Leje Minerare e Kerkim-Zbulimi eshte 7.014 km².

Aktiviteti i kerkim-zbulimit parashikohet te perqendrohet brenda te gjithë siperfaqes se lejes, dhe konsiston ne kryerjen e punimeve te ndryshme gjeologo-minerare. Aktiviteti parashikohet te zhvillohet ne dy faza:

Faza e pare, periudha 2019-2021 do te kryhen punimet e meposhteme:

, - Rikonicioni gjeologjik i zonës së licensuar për (7.014 km²), vrojtimi në terren i formacioneve gjeologjike që ndërtojnë zonën, marrja e kampioneve sipas llojeve shkëmbore që ndërtojnë këtë zonë, si dhe matja e disa elementeve strukturore në shkëmbinj me qëllim përcaktimin e orientimit të azimuteve të drejtimit të profileve gjeologjike, pikave të forta topografike etj, që do të shërbejnë për kryerjen e rievimit gjeologjik të zonës. Do të marrin pjese 1 inxh. Gjeolog dhe topografi dhe 2 punëtorë për një kohe 15 ditore në terren duke kryer 20 kml marshuta redaksionale + vrojtimi i detajuar në objekte.

-Verifikimi i punimet sipërfaqësore të kryera me parë në terren, me qëllim matjen e elementeve të rënies se zonës krom-mbajtëse.

- Kryerja e rievimit topografik e me pas atij gjeologo-strukturore në shk. 1:2000, trasimi i profileve dhe magjstralit të rievimit nga topografi dhe përpilimi i hartës gjeologo-strukturore nga gjeologu i subjektit, për një sipërfaqe 7.014 km². Profilet do të jenë në distancë çdo 40 m

dhe piketat çdo 20 m për këtë shkallë të përpilimit të hartës, e cila do të reflektoj të gjitha llojet shkëmbore, zonat tektonike, serinë damarore elementet strukturore dhe sidomos zonat krommbajtes (shliret e kromit) e mineralet e tjerë të dobishëm që mund të gjenden në këtë shesh. Për kryerjen e këtij rievimi do të duhet 3 muaj kohë për gjeologun, topografin dhe 4 punëtorë (3 topografi dhe 1 gjeologu).

- Për të vlersuar trashësinë cilësinë dhe për tësaktësuar në sipërfaqe morfologjinë e trupit, të marrëdhënjet me shkëmbinjtë rrethues do të hapen **25 kanale dhe (mini kariera)** në sipërfaqe me gjatësi jo me pak se 20 ml secili dhe thellësi 1.5-2 m. Kanalet do të kryhen në kohën që gjeologu është në terren duke kryer punimet e fazës së parë.

Hapja e kanaleve të reja do të bëhet në zonat krom-mbajtëse të njohura dhe daljet e gjetura nga rievimi, si dhe do të bëhet edhe **ripastrimi i kanaleve** të vjetra. Volumi i parashikuar i kanaleve dhe karierave e ripastrimit të atyre të hapura më parë do të jetë **1500 m³**.

Gjatë kësaj fazë do të bëhet edhe hapja e rrugëve gjurmë për dërgimin e mjeteve në objekt duke bërë rreth **1000 m³** gërmime.

- Në këtë fazë paralelisht me rievimin gjeologjik dhe përpilimin e hartës gjeologjike fushore do të bëhet edhe ndjekja e dokumentimi i punimeve sipërfaqësore e nëntokësore të kryera, lidhja topografike e tyre dhe marrja e provave për analizë kimike (**50 copë**), petrografike, marrja e anshlifeve, analiza fiziko-mekanike; me qëllim vlerësimin cilësor të zonave të mineralizuara të kromit. Muajt korrik-shtator, ing. Gjeologu, topografi.

- Azhurnimi i plotë i punimeve gjeologjike të kryera në terren, lidhja e tyre me koordinata shtetërore, hedhja në hartën gjeologjike dhe në planimetri, përgjithësimi i rezultateve të marra nga këto punime, analiza e të dhënave dhe marrja e vendimit për kryerje ose jo të punimeve për fazën e zbulimit të detajuar të objektit apo mineraleve të reja që mund të lokalizohen në sheshin tonë. Tetor-Dhjetor, inxh. Gjeologu, topografi

- Kryerja e analizave kimike në laboratorë të liçensuar (Sh.Gj.Sh), si studimi i kampioneve petrografike, mineralogjike etj.

Faza e dyte, nga mesi i vitit 2021-2022, merret vendimi për vijushmerinë e mëtejshme të vlerësimit të zonës e zbulimin e rezervave do të kryhen këto punime:

- Do të bëhet kërkim-zbulimi i objektit apo daljeve të tjera në krahë dhe në thellësi, me punime gjeologjike (minerare dhe shpime), për secilin rast; kushtëzuar nga kushtet gjeologo-morfologjike të vendosjes së mineralizimit, si trajta e trupave, elementet e shtrishmërisë së tyre, marrëdhënja me shkëmbinjtë rrethues, shpërndarja e përbërësit të dobishëm, kushtet e relievit etj. Për këtë fazë do të ndiqet mënyra e kombinuar e kryerjes së punime për zbulimin e objektit e cila do të konsistojë në:

-**Hapje kanaleve të reja, dhe pastrim të kanaleve të vjetra, pastrim pusesh të vjetrapër** të ndjekur në shtrirje trupin xeheror.

- **Punime shpimit**, të cilat do të jenë si kohe kryerje krahas së kryerjes së punimeve sipërfaqësore pamvarsisht marrjes së rezultateve të punimeve minerare. Fillimisht për të kontrolluar horizontin ku pritët të gjenden trupi apo linxa krommbajtëse, do të orientohen profile kryq strukturës e

shkëmbinjve ku ato lokalizohen, që do të jenë shpime zbulim me një rrjet (20 x 20,) sipas *shfaqjeve të mineralizuar nr.2 (Livadhi i Laskut) ,nr. 6 (Stani i Jakupit) ,nr.10 (Stani Can Lushës) , nr .19 dhe 20 sipas hartës gjeologjike strukturale e masivit ultrabazik të Kukësit me autor Isa Baja Haki Caçli viti 1968 që ndodhen brenda zonës minerare 566/1.* Rezervat në rast rezultatesh pozitive të këtyre shpimeve të kërkimit-zbulimit do të jenë të kategorisë C₁, dhe C₂.

- Për zbulimin e xeherorit të kromit në këto objekte si në shtrirjes ashtu dhe në rënies, kemi projektuar **1284 ml** shpime të pavarura, **450 ml** shpime të varur nga rezultatet e shpimeve të pavarur ,të cilat do të jenë në varësi si të rezultateve që do të merren nga kanalet e punimet minerare dhe të vete të dhënave që do të merren gjatë kryerjes së tyre. Shpimet janë projektuar me rrjet (20 x20,)pra me hap 20 ml në shtrirje, dhe 20 ml në rënie, kjo për arsye të morfologjisë dhe zonalitetit të shpërndarjes së mineralit të dobishëm në trupin xeheror për zbulimin e rezervave të kategorisë C₁ ,ndërsa për rezerva të kategorisë C₂ do të përdoret rrjeti (40 x 40, ml) .Shuma e shpimeve të projektuara do të jetë rreth **2284 ml të pavarura**. Theksojmë se për konturimin e trupit në thellësi dhe shtrirje rrjeti i punimeve sipas objekteve do të jetë 20 x 20 ose profilet do të jenë larg njeri-tjetrit 40 m, ndërsa shpimet ne profil do te jenë 30 m larg njeri-tjetrit gjatë rënies së trupit të kromit.

Gjatë dy viteve (të kërkimit-vlerësimit dhe kërkim-zbulimit) paralelisht me kryerjen e punimeve gjeologjike, do të bëhet edhe vlerësimi cilësor i trupave dhe zonave minerale, nëpërmjet marrjes se provave për analiza kimike të komponentit të dobishëm Cr₂O₃, SiO₂, Al₂O₃ etj me prova të rradhës, si dhe vlerësime me prova të bashkuara për analiza të plota kimike do të merren 1-2 prova.- Për vlerësimin e cilësive pasuruese të objektit (1 provë teknologjike për pasurim) do të merret provë teknologjike (të bashkuara nga punimet e shpimit apo nga galeritë e karierat) për trupat krombajtës të zonës, për të cilat do të gjykohet para se të marrim lejen per shfrytëzim.

- Me mbarimin e afatit të liçencës sipas ligjit minerare, do të përpilohet raporti përfundimtare për këtë kategori leje (kërkim-zbulimi), me rezultatet e kërkim-zbulimit dhe llogaritjen e rezervave të mineralit të kromit, konform kërkesave të ligjit dhe akteve nënligjore të miratuara dhe me vonë studimi tekniko-ekonomik për marrjen e lejes së shfrytëzimit.

- Progresivisht me punimet e kërkim-zbulimit dhe kushtëzuar nga rezultatet e fituara, do të synohet konvertimi i kësaj kategorie leje, në leje minerare shfrytëzimi, për objektet me rezultate të mira.

C) Informacion per qendrat e banuara

Ne afersi te objektit nuk ka zona te banuara.

Planimetria vendodhjes se objektit dhe foto te objektit , kordinatat

D) Pershkrim i proceseve ndertimore dhe teknologjike , kapaciteti prodhues .

Vendosja e makinerive te shpim kerkimit te kromit, si motorkompresore, sonda, eskavatore, martel, kamiona etj.

Gjate kryerjes se proçesit te kerkim zbulimit mineralit te mineralit te kromit do te punojne nje brigade punonjesish. Te gjitha keto makineri do te punojne me nafte.

DH) informacion peri nfrastrukturen e nevojshme per lidhjet me rrjetin elektrik dhe furnizimin me uje

Ndertimi i rruges hyrese per ne objekt.

Do te ndertohet rruga deri tek objekti.

Ndertimi i linjes elektrike.

Ne objekt nuk ka nevoje per lidhjen e linjes elektrike pasi te gjitha makinerite punojne me nafte.

1. Te dhëna mbi identifikimin e ndikimeve ne mjedis gjate hapjes se punimeve minerare

a. Dëmtimi i sipërfaqes se tokës,

Çdo aktivitet minerare qe zhvillohet për një leje minerare kërkim-zbulimi, shoqërohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis. Prandaj konform kërkesave te ligjit minerare e akteve qe rrjedhin prej tij, nga shoqëria jone për punimet qe do te zbatohet sipas këtij programi pune ka planifikuar shpenzime financiare për rehabilitimin e tij. Megjithatë e rëndësishme është qe te kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikesht ndikimet e çdo operacioni te kryer, sidomos mbi burimet natyrore te parinovueshme. Industria minerare është shume e rëndësishme ne ekonominë e një vendi, por ajo shoqërohet edhe me ndikime mjedisore negative, te cilat ne disa raste mund te jene te pashmangshme. Shume prej ndikimeve negative mjedisore mund te minimizohen përmes një planifikimi te kujdesshëm mjedisor dhe aplikimit te teknikave dhe teknologjisë se parandalimit te ndotjeve.

Vlerësimi i ndikimeve te mundshme si pasoje e veprimtarisë behet duke u nisur nga një sere faktorësh qe lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, sasinë e energjisë, lendet e para te përdorura dhe mbetjet e gjeneruar, te gjitha këto ne kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik. Kur flasim për shfrytëzim te resurseve minerare duhet te marrim ne konsiderate përdorimin e makinerive te renda, te eksploziveve si dhe zhvendosjen e transportin e sasive te mëdha te mineralit nga nëntoka. Bazuar ne mënyrën e

propozuar për kërkim-zbulim ndikimet me thelbësore mund dhe duhet te analizohen sipas fazave te veprimtarisë minerare te këtij aktiviteti, si:

Dëmtimi i sipërfaqes se tokës, erozioni gjate hapjes dhe kryerjes se punimeve dhe masat për dëmtimet te sipërfaqes se tokës nga operacionet e gërmimit.

Ne projektin e paraqitur janë projektuar punime sipërfaqësore (kanale, pastrime hapje rrugësh), punime minerare (galeri, puseza) dhe ndoshta mund te kryhen edhe shpime.

1. Sasia e materialit qe do te dali nga gërmimet do te sistemohet përgjatë rruges, ne anët e kanaleve te hapura dhe te përdoret për qëllime rehabilitimi ne faza te ndryshme te shfrytëzimit ose për rehabilitimin e këtyre sipërfaqeve te dëmtuara ne përfundim te afatit te veprimtarisë minerare.

2. Do te piketohen dhe hapen kanalet e drenazhimit ne sipërfaqet ku është punuar. Përgjatë segmenteve rrugore ne varësi te terrenit dhe kushteve te tokës do te hapen kanale anësore qe do te ndalim forcën gërryese te ujërave te reshjeve. Ne pjese te veçanta do te shihet mundësia e mbjelljeve te fidanëve pyjore te përshtatshëm për zonën fito-klimatike.

3. Për parkimin e makinerive dhe automjeteve dhe kryerjen e shërbimeve te mirëmbajtjes do te shfrytëzohen vendet e caktuara.

4. Makineritë qe do te përdoren do te kontrollohen për gjendjen e tyre teknike dhe nëse konstatohen pjese te amortizuara qe mund te rrjedhin lubrifikante do te zëvendësohen me te reja. Ne rast te ndonjë aksidenti dhe rrjedhjeve aksidentale te lendeve ndotëse ne mjedis do te merren masa për pastrimin e menjëhershëm te tokës se ndotur e cila do te depozitohet ne një kazan te posaçëm metalik ose prej betoni për t'u djegur me pas

b. Dëmtimi i florës, faunës dhe bimët e ujit dhe masat parandaluese e rehabilituese;

Ne zonën ne te cilën do te zhvillohet aktiviteti nuk ka ndonjë lloj ose specie flore apo faune qe mbrohet me status te veçante. Flora dhe fauna lokale nuk do te preket, mbasi sipërfaqja e objekti është po-thuajse e zhveshur nga bimësia. Megjithatë shoferet do te udhëzohen te bëjnë kujdes gjate transportit ne zona pyjore për te mos shtypur kafshe qe mund te jene ne mes te rruges.

c. Shkarkimet e ujërave, pluhurat gjate procesit te punës, zhurmat, emetimi i gazrave nga pajisjet, mjeteve motorike dhe makineritë, ndikimi ne mjedis i produkteve te lendeve plasëse dhe masat përkatëse;

1. Do te piketohen dhe hapen kanalet e drenazhimit ne sipërfaqe. Përgjatë segmenteve rrugore ne varësi te terrenit dhe kushteve te tokës do te hapen kanale anësore qe do te ndalim forcën gërryese te ujërave te reshjeve.

2. Makineritë duhet të mirëmbahen teknikisht që zhurma e tyre të jete vetëm ajo teknologjike dhe jo e avarive. Ato duhet të përdoren me efikasitet dhe të minimizohet koha gjatë së cilës mbahen ndezur motorët. Skapamentot duhet të kenë në gjendje funksionale filtrat e tyre teknologjike të kapjes së grimcave (skapamentot e makinerive kanë një jastëk të posaçëm për këtë gjë). Do të përdoret naftë me përmbajtje të ulët squfuri. Transporti i materialeve të bëhet me mjete të pastra nga balta dhe të mbuluara nëse rrugët kalojnë pranë ose nëpër qendrat e banuara. Të mënjanohet rënia e borive të automjeteve nga shoferet për të mos krijuar zhurmë dhe stres tek banoret. Qarkullimi i kamionëve në qendrat e banuara të bëhet me shpejtësi të ulët gjë që shmang jo vetëm aksidentet por edhe krijimin e pluhurave.

3. Gjatë proceseve të punës nuk duhet të dëmtohen sipërfaqe të panevojshme si pasojë e mos planifikimit të saktë apo e neglizhencës së punëtorëve që mund të presin pemë apo të shkaktojnë zjarre dhe dëmtojnë peizazhin dhe bimësinë e zonës.

4. Gjatë kërkimit zbulimit të objektit parashikohet edhe përdorimi i lëndës plasëse me pak se 1 ton /vit. Ndikimi i përdorimit të lëndës plasëse do të jete i pakonsiderueshem.

d. Masat për rigjenerimin e peizazhit;

Masat për rigjenerimin hap pas hapi, krahas shfrytëzimit të objektit konsistojnë në:

- Krijimin e sipërfaqeve për mbjellje.
- Sistemimin e materialit të mbulesës të depozituar
- Mbjelljen e sipërfaqeve të reja me fidanë pishë dhe barishte të ndryshme;
- Mirëmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella;
- Për shmangien dhe parandalimin e erozionit, shembjes së sipërfaqes dhe vithisjeve të ndryshme, në projekt është përcaktuar një sistem pune harmonik dhe i kombinuar në kohë dhe hapësirë të zonës në tërësi.
- Në zonën e kërkimit zbulimit hap pas hapi dhe në përfundim të aktivitetit është parashikuar mbushja e sistemit, përpunimi dhe mbulimi i sipërfaqes që do të dëmtohet.
- Kjo sipërfaqe e përfituar nga trajtimet e mësipërme do të japë mundësi minimale për rikultivimin e bimëve dhe pemëve të ndryshme lokale, duke krijuar kushte për parandalimin e erozionit dhe përmirësimin të pamjes së përgjithshme të zonës së shfrytëzuar.
- Gjatë veprimtarisë dhe në përfundim të saj do të ruhen parametrat e sipërfaqeve të mbuluara për të lejuar rrjedhën normale të ujërave të reshjeve dhe parandaluar grumbullimin dhe shpëlarjen e sipërfaqes së shfrytëzuar dhe të mbuluar;

e. Ndikimi në infrastrukturën e zonës së objektit dhe masat përkatëse;

Aktiviteti i transportit që do të kryet nga subjekti i shfrytëzimit nuk e rëndon trafikun aktual mbasi numri i kamionëve që do të kalojnë në të është i vogël.

r. Ndikim ne shëndetin e njerëzve qe punojnë ne objekt dhe ne jetën e banoreve për rreth, qarkullimin dhe transportin dhe masat përkatëse;

Punonjësit qe do te jene prezent ne objekt gjate veprimtarisë do te jene te mbrojtur nga mjetet personale mbrojtëse kundra pluhurit dhe zhurmave te cilat do te jene te kufizuar vetëm brenda zones se kërkim zbulimit. Si rrjedhoje e projektit dhe ndikimeve pasuese mjedisore ne te, nuk do te këtë dhe nuk priten ndikime ne shëndetin e popullsisë se zones dhe punonjësve te saj. Për pasoje nuk priten zhvendosje te tyre për shkak te këtij aktiviteti.

Plani i monitorimit te mjedisit dhe rehabilitimit

Aktiviteti kërkim-zbulimit si aktivitet minerar vepron në sipërfaqen e tokës. Pjesa e relievit ku do të zbatohet aktiviteti është pjesërisht i cenuar nga punime nëntokësore, gërmime dhe shpime te kryera vite me pare nga ish ndërmarrja gjeologjike Kukes, por zona është e varfër për nga zhvillimi i bimë-sisë. Në përfundim të aktivitetit minerare te shoqërisë tone me marrjen e lejes, e cila është caktuar ne baze te ligjit 3 vjet, do të duhet që të transformohen sipërfaqet e dëmtuara nga punimet tona, në një reliev të ri natyror, në një sipërfaqe në formën e sotme por te mbuluar nga vegjetacioni dhe në terrene të gjelbëruara. Masat për rehabilitimin e sektorëve të sipërpërmendur që çënojnë terrenet do të zbatohen hap pas hapi, krahas aktivitetit te zbulimit dhe konsistojnë në:

- Sistemimin në sipërfaqen ekzistuese ku do te zhvillohet zbulimi nëpërmjet mbjelljes se pemëve për te rritur kohezionin e saj pasi te këtë përfunduar puna;
- Hapja e gropave ku do të mbillen fidanët dhe mbushjen e tyre me dhera vegjetale;
- Mbjelljen e sipërfaqeve të krijuara si më sipër dhe sipërfaqeve të reja në territorin e zones me pe-më natyrore (pisha, etj.) dhe barishte të ndryshme;
- Mirëmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella për një kohë 4 vjeçare pas dorëzimit të lejes se kërkim zbulimit.

Duke konsideruar sipërfaqet e shesheve që zënë punimet e projektuara për zbulim prej 2000 m², në tabelën e mëposhtme jepen shpenzimet e rehabilitimit:

Kapaciteti joprodhues -

KAPACITETI LEVIZJES SE VOLUMEVE DO TE JETE 1000-2000 m³/vit.

STUDIO " OSKEOLA" SHPK

ADMINISTRATORI

LEK BICUKU



Studio projektuese "Oskeola" sh.p.k
Nr.cel 068 5095 197
Email : indrit.mijat@yahoo.com